



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 74, datë 30.03.2023

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË VKB-NË NR.153, DATË 22.12.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PROFESIONAL DHE KONVIKTEVE TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “BEQIR ÇELA” DHE SHKOLLËS SË MESME TEKNOLOGJIKE “HYSEN ÇELA”, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.10.2019 ”Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në Institucionet Arsimore Parauniversitare Publike” i ndryshuar, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 522, datë 21.10.2022 “Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2022-2023”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 521 datë 21.10.2021 “Për ngritjen e komisioneve pranë Shkollave të Mesme Teknologjike, Profesionale dhe Sportive të qytetit të Durrësit, për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2022-2023”, shkresën nr. 20315 prot., datë 03.11.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në Bashkinë Durrës me nr.9014 prot., datë 07.11.2022, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.153, datë 22.12.2022, përsa i përket heqjes së bursës për nxënësin me nr.rendor 31, në tabelën 1, të pikës 1 “Miratimin e listës emërore të nxënësve të Shkollës së Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela”, të Shkollës së Mesme Profesionale Kombëtare “Charles Telford Ericson”, Golem Kavajë, Shkollës së Mesme të Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi” Tiranë dhe Shkollës Teknike Elektrike “Gjergj Cano” Tiranë”, si më poshtë vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Viti	Data e largimit	Arsyeja e largimit
31	Rei Lutfi Hoxha	X	16.12.2022	Mungesa

2. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.153, datë 22.12.2022, përsa i përket heqjes së bursës për nxënësin me nr. rendor 209, në tabelën 2, të pikës 2 “Miratimin e listës emërore të nxënësve të Shkollës së Mesme Teknologjike “Hysen Çela” dhe Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” të viteve të dyta e lart, që ruajnë bursën”, si më poshtë vijon:


Nr.	Emër Mbiemër	Viti	Data e largimit	Arsyeja e largimit
209	Oresi Arben Kamberaj	XI	26.01.2023	Mungesa

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare dhe Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 03.04.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 232 prot.
2

Durrës, më 06.04.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

6 4 23 2560/10

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.74 datë 30.03.2023 “Për miratimin e ndryshimeve në VKB-në nr.153, datë 22.12.2022 “Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit profesional dhe konvikteve të shkollës së mesme profesionale “Beqir Çela” dhe shkollës së mesme teknologjike “Hysen Çela”, që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2022-2023””.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI